

Statistika mbi Kërkimin Shkencor dhe Zhvillimin


Viti 2021-2022

Tiranë, më 06 Dhjetor 2024: Instituti i Statistikave publikon për herë të parë të dhënat e Kërkimit Shkencor dhe Zhvillimit (K&ZH). Mbledhja e të dhënave organizohet për secilin sektor të performancës, përkatësisht Sektori Shtetëror, Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL), Ndërmarrjet Private dhe Organizatat Jofitimprurëse (OJF). Të dhënat, të cilat i referohen periudhës 2021-2022, janë mbledhur me metodë të kombinuar. Në kushtet e zhvillimit të shpejtë të shkencës dhe teknologjisë, ky sektor merr rëndësi të veçantë, sidomos në sektorët strategjik me prioritet për vendin. Shkenca dhe teknologjia janë pjesë e çdo aspekti të jetës sonë të përditshme dhe ato, së bashku me inovacionin, ndihmojnë në trajtimin e disa prej sfidave të mëdha revolucionare dhe transformativë me të cilat po përballlet shoqëria. Sfidat e cilat çojnë në rritjen e interesit për investime në këtë sektor, me ndikim të drejtëpërdrejtë në ekonominë e vendit.

Personeli i angazhuar, sipas sektorëve të performancës dhe nivelit arsimor

Në vitin 2022, 3.748 persona janë angazhuar në aktivitetin e K&ZH në Shqipëri me kohë të plotë dhe të pjesshme. Ky numër përcaktohet si numri i personave që punojnë për konceptimin dhe krijimin e dijeve, produkteve, proceseve, metodave dhe sistemeve të reja. Në personelin e angazhuar në K&ZH gjatë vitit 2022 sipas gjinisë, 54,4 % e zënë femrat, ndërkohë gjatë vitit 2021 përqindjen më të lartë e zënë meshkujt me 50,6 %.

Fig. 1 Personel i angazhuar në aktivitete të K&ZH sipas gjinisë, 2021-2022



Për publikim 06/12/2024

Gjatë vitit 2022, numri më i lartë i **personelit të angazhuar** në K&ZH i përket sektorit të IAL-ve me 81,6 %, pasuar nga Ndërmarrjet Private dhe OJF-të me 9,6 % dhe Sektori Shtetëror me 8,8 %.


Gjatë vitit 2022, Kërkuesit Shkencor zënë pjesën më të madhe të personelit të angazhuar në K&ZH me rreth 55,2 %, Personel Profesionist me 21,6 %, Personel Teknik me 10,6 % dhe Personel Mbështetës me 12,6 %, ndërkohë gjatë vitit 2021 struktura e personelit ishte përkatësisht, Kërkuesit Shkencor 55,3 %, Personeli Profesionist me 20,5 %, Personeli Teknik me 11,0 % dhe Personel Mbështetës me 13,2 %.

Tab. 1 Personel i angazhuar në Kërkim Shkencor dhe Zhvillim, 2021-2022

	Sektori Shtetëror		Institucionet e Arsimit të Lartë		Ndërmarrje Private dhe OJF	
	2021	2022	2021	2022	2021	2022
Kërkues shkencor	195	209	1.670	1.731	138	131
Personeli profesionist	23	43	569	661	152	107
Personeli teknik	35	35	265	295	99	62
Personel mbështetës	36	43	439	372	9	59
Gjithsej	289	330	2.943	3.059	398	359


Në vitin 2022, bazuar në klasifikimin sipas **niveleit arsimor** për sektorin e IAL-ve, personeli me nivel arsimor “Doktorant” zë peshën më të madhe me 51,2 % dhe krahasuar me vitin 2021 është rritur me 5,2 %.

Fig. 2 Shpërndaja e personelit të angazhuar në K&ZH sipas nivelit arsimor tek IAL-të, 2021-2022



Referuar klasifikimit sipas nivelit arsimor, për Sektorin shtetëror vihet re se personeli me nivel arsimor “Master ose ekuivalent të tij” është rritur me 5,8 % gjatë vitit 2022, krahasuar me vitin 2021.


Fig. 3 Shpërndaja e personelit të angazhuar në K&ZH sipas nivelit arsimor tek Ndërmarrjet dhe OJF-të, 2021-2022



Fondet dhe shpenzimet sipas sektorëve të performancës


Në periudhën kohore 2021-2022, pesha më e madhe e **fondeve** për aktivitetet e K&ZH, sipas strukturës së sektorëve të performancës, i është akorduar sektorit të Institucioneve të arsimit të lartë (IAL-ve) përkatësisht me 53,6 % gjatë vitit 2021 dhe 52,5 % gjatë vitit 2022.

Fig. 4 Shpërndaja e fondeve të K&ZH sipas sektorëve, 2021-2022



Në periudhën 2021-2022, sipas strukturës së sektorëve të performancës, Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL-të) mbajtën peshën kryesore të **shpenzimeve** në aktivitetin e Kërkimit dhe Zhvillimit (K&ZH), përfshirë shpenzimet korente dhe ato kapitale, duke kontribuar përkatësisht me 57,9% në vitin 2021 dhe 53,1% në vitin 2022.

Fig. 5 Shpërndaja e shpenzimeve në aktivitete të K&ZH sipas sektorëve, 2021-2022



Metodologjia

Vrojtimi statistikor mbi aktivitetin e kërkimit shkencor dhe zhvillimit, zhvillohet çdo dy vite dhe periudha e vëzhgimit të mbuluar është periudha dy-vjeçare (2021-2022). Të dhënat janë mbledhur me pyetësorë, me metodë të kombinuar. Sektorët e përfshirë në këtë vrotim janë:

Sektori shtetëror, Institucionet e arsimit të lartë (IAL) mbulim i plotë, Ndërmarrjet private dhe OJF, të mbledhur me vrotim statistikor, me kampion, njësitë të cilat plotësojnë kriterin me 10 ose më shumë të punësuar. Në këto dy sektorë u intervistuan një kampion prej 1,715 ndërmarrje dhe OJF.

Përkufizime:

“**Kërkimi dhe Zhvillimi (K&Zh)**” përbëhet nga një punë kreative dhe sistematike e ndërmarrë me qëllim të rritjes së stokut të njohurive - duke përfshirë njohuritë për njerëzimin, kulturën dhe shoqërinë - dhe për të krijuar aplikacione të reja nga njohuritë e fituara.

Kërkimi shkencor përfshin punën kreative dhe hulumtimin origjinal të ndërmarrë mbi baza sistematike për të fituar njohuri të reja, duke përfshirë njohuritë për njerëzimin, kulturën dhe shoqërinë.

Zhvillimi eksperimental është zbatimi i gjetjeve të hulumtimit ose njohurive të tyre shkencore për krijimin e produkteve, aplikacioneve, proceseve të reja ose të përmirësuara ndjeshëm.

Kriteri bazë për dallimin e aktivitetit të K&Zh nga aktivitetet e lidhura me të është pranimi në këtë aktivitet të një elementi të dukshëm *risie* dhe zgjidhja e pasigurisë shkencore dhe/ose teknologjike (pasiguria që rrjedh kur zgjidhja e një problemi nuk është e qartë për dikë që njih bazën e njohurive dhe teknikave të përdorura në fushën përkatëse).

Që një aktivitet të jetë një aktivitet K&ZH, ai duhet të plotësojë pesë kriteret thelbësore.

- i ri
- krijues
- i papërcaktuar
- sistematik
- i transferueshëm dhe/ose i riprodhueshëm

Fushëveprimi i vrotimit:

Kërkimi shkencor dhe zhvillimi pranë sektorit privat përfshin:

Çdo aktivitet i klasifikuar si K&Zh karakterizohet nga origjinaliteti; duhet të ketë investigimin si një objektiv

parësor dhe duhet të ketë potencialin për të prodhuar rezultate që janë mjaft të përgjithshme dhe të rriti njohuritë (qofshin teorike dhe / ose praktike) mbi njerëzimin.

Kërkimi bazë:

Quhet puna eksperimentale ose teorike e ndërmarrë kryesisht për të fituar njohuri të reja mbi bazat themelore të dukurive dhe fakteve të vrojtueshme, pa pasur parasysh ndonjë zbatim apo përdorim të caktuar.

Kërkim i zbatuar:

Quhet kërkimi origjinal i ndërmarrë për të fituar gjithashtu njohuri të reja. Por, ai është i drejtuar kryesisht në arritjen e qëllimeve ose objektivave praktike të caktuara.

Zhvillim eksperimental:

Quhet puna sistematike e ndërmarrë mbi bazën e njohurive ekzistuese të fituara nga kërkimi dhe/ose eksperiencia praktike, që është e drejtuar në prodhimin e materialeve, produkteve ose pajisjeve të reja, në futjen e proceseve, shërbimeve të reja, ose në përmirësimin rrënjësor të atyre të prodhuara ose të futura mëparë.

Kërkues shkencor: është personeli profesionist i angazhuar në konceptimin ose krijimin e njohurive të reja, produkteve, proceseve, metodave, sistemeve dhe gjithashtu në manaxhimin e projekteve në fjalë. Personat me arsim pas-universitar (Doktorantë) të përfshirë në K&Zh duhet të konsiderohen kërkues shkencor.

Personel teknik: janë personat të cilët kanë njohuri kryesore teknike dhe eksperiencë në një apo më shumë fusha si: shkencat inxhinjerie, fizike apo shkencat shoqërore dhe humane. Ata marrin pjesë në K&Zh duke kryer vrojttime shkencore dhe detyra teknike që përfshijnë zbatimin e koncepteve dhe metodave operative, zakonisht nën mbikqyrjen e hulumtuesit (kërkuesit shkencor); p.sh. personeli që përgatit programet kompjuterike, teston të dhënat, i analizon ato, etj.

Personel profesionist: janë si rregull, persona me arsim të lartë të punësuar në pozicione profesionale (bibliotekarë, specialistë të TI-së, ekspertë të informacionit, etj.), Të cilët marrin pjesë në kërkime shkencore dhe punë kërkimore dhe zhvillimore, por nuk janë bartës të projekteve kërkimore dhe zhvillimore.

Personel mbështetës: përfshin personelin e kualifikuar dhe të pakualifikuar pjesëmarrës në K&Zh ose të lidhur drejtpërdrejt me të; p.sh. personeli administrativ si: sekretarja, operatorët etj.